



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPËSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 01-060/01-0013675/24
No. 13.03.2024
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 52, par.1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe nenit 12, par.1,2,3,4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve te përhershme në Komunë, Kryesuesja e Kuvendit:

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, e cila mbahet me datën **21.03.2024**
(ditë e enjte) me fillim në orën **11:00**, në Sallën e Bordit të Drejtorëve

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për formomini e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr. 02-020/01-0013489/24, të datës 12.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
5. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02.020/01-0013678/24, të datës 13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013528/24, me Nr.13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
7. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013526/24, të datës 13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
8. Të ndryshme.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0013675/24
Data 13.03.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 21.02.2024, në ora 14:00, në sallën e bordit të drejtoreshave.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, Nr.05-020/01-0009631/24, datë 13.02.2024, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
5. Të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar KPF-së, Kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së,

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

- Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, me Nr.05-020/01-0009631/24, datë 13.02.2024, (Raporton),

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Informatë lidhur me ndryshimet rrënjësore në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, të cilat i ka parapa ligji i ri Nr.08/L-237, që tash veç ka hyrë në fuqi, që përmes këtij ligji do të bëhet një organizim vertikal institucional duke përfshirë zyrën kadastrale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Qytetaret këtu faktikisht do të përfitojnë, po ne si komunë do të humbasim një pjesë të te hyrave vetanake, mirëpo do të krijohen disa lehtësira sa i përket regjistrimit të pronës, mirëpo duke bashkëpunuar me agjencionin i kemi punuar 14 UA, në disa pjesë ku nuk jemi pajtuar me ligjin i kemi futur si ndryshime në UA, po gjithashtu duke mos i ikur bazës ligjore. Këto UA do të paraqesin ndryshime rrënjësore pra në formimin e komisioneve të reja, dhe nen komisioneve, ku komisioni kryesorë për rindërtimin e informacioneve ku ky komision do të krijojë lehtësira qytetarëve si në regjistrimin e pronës, në korrigjimin e të dhënave, ku në kataster këto telashe i kemi tash e sa kohe, për arsye së nuk kemi të dhëna të sakta të personave dhe pronave. Ky komision do të shkojë lagje në lagje, familje në familje, ku përmes deklaratës nen betim të cilën do ta nënshkruajnë edhe dy dëshmitar të cilët do të behet regjistrimi i pronës të cilat ato prona janë ble veç me pare në dorë. Punëtorët do të kalojnë në kuadër të Agjencisë dhe të menaxhohen nga agjencia po do të jenë në kuadër të institucionit, komunës i jesin vetëm punëtorët e sektorit të pronës, ju ftoj me përkrah.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, Konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstënim rekomandohet për kuvend për miratim Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, me Nr.05-020/01-0009631/24, datë 13.02.2024.

Vazhdojmë me pikën 5 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, fjalën ja kaloj:

Ilir Ejupi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, e kam një pyetje rreth përbërjes së KPF-së, a e ken i planifikua që me bë zëvendësimin e anëtares së KPF-së në këtë seancë?

Kryesuesja: Po Ilir në këtë seancë behet zëvendësimi i anëtares së kuvendit, po ashtu edhe të anëtares së KPF-së, se e kemi marr vendimin nga KQZ-ja, dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, me datë 29.02.2024, ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ
SKENDERAJ

Nr. _____
No. 02-020/01-0013489/24
Data _____
Data. 12.03.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, në mbledhjen e rregullt të KPF-së dhe Kuvendit Komunal, të datës 29.03.2024, Kryetari i Komunës propozon këtë:

PROPOZIM V E N D I M

- I. Propozohet miratimi i vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, në këtë përbërje:
1. Një (1) anëtar nga ekzekutivi (DShMS)
 2. Një (1) anëtar nga shoqëria civile (ShFD e UÇK-së)
 3. Tre (3) anëtar nga Kuvendi
- II. Detyrë e komisionit është që të bëjë shpalljen e thirrjes publike, shqyrtimin e aplikacioneve, përzgjedhjen e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje, si dhe propozimin për miratim në Kuvendin Komunal.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Propozimi i dërgohet:

- Kryesueses së Kuvendit
- DShMS -së
- Arkivit

Kryetari i Komunës


Fadil Nura





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY OPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0013678/24
Data.
Data. 13.03.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt të datës 03.12.2008, në mbledhjen e rregullt të KPF-së dhe mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, të datës 29.03.2024, Kryetari i Komunës propozon këtë:

PROPOZIM V E N D I M

- I. Propozohet miratimi i vendimit për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, në përbërje prej **tre (3) anëtarëve nga Kuvendi i Komunës**
- II. **Detyrë e komisionit** është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe brenda afatit prej 15 ditësh nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthej përgjigjie me shkrim parashtruesve të ankesave, si dhe për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Propozimi i dërgohet:

- Kryesueses së Kuvendit
- Arkivit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SHUPËSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0013528/24
Data.
Data. 13.03.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt të datës 03.12.2008, si dhe mbështetur në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane dhe Rregulloren Nr. 01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, të Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të KPF-së dhe Kuvendit Komunal, të datës 29.03.2024, Kryetari i Komunës propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

- I. Propozohet miratimi i vendimit për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, në këtë përbërje:
 1. Katër anëtarë nga Kuvendi i Komunës (nga subjekte të ndryshme)
 2. Një (1) anëtar nga Ekzekutivi
 3. Një (1) anëtar nga Shoqëria Civile
 4. Një (1) anëtar nga lokaliteti (fshati, vendbanimi apo lagjja)
- II. Detyrë e komisionit është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale dhe për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.
- III. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.
- IV. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Propozimi i dërgohet:

- Kryesueses së Kuvendit
- Arkivit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/61-0013526/24
Data.
Data. 13.03.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt të datës 03.12.2008 dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, të Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të KPF-së dhe Kuvendit Komunal, të datës 29.03.2024, Kryetari i Komunës propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

- I.** Propozohet miratimi i vendimit për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, në përbërje prej **tre (3) anëtarëve nga Kuvendi i Komunës**
- II.** **Detyrë e komisionit** është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe brenda afatit prej 15 ditësh nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthej përgjigjie me shkrim parashtruesve të ankesave, si dhe për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës.
- III.** Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Propozimi i dërgohet:

- Kryesueses së Kuvendit
- Arkivit

